VLERËSIMI I HAPËSIRAVE PËR KORRUPSION

NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR

6 Mars 2017

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTËR SHTETI
PËR ÇËSHTJET VENDORE

Kingdom of the Netherlands

idra
INSTITUTE FOR DEVELOPMENT RESEARCH AND ALTERNATIVES

ÇFARË ËSHTË VLERËSIMI I HAPËSIRAVE ANTIKORRUPSION ?

- Është analizimi dhe shqyrtimi i draft ligjeve dhe akteve nënligjore, duke evidentuar hapësirat dhe risqet potenciale që mund të sjellin korrupsion, pavarësisht nëse këto risqe kanë qenë të qëllimshme ose jo.
- Është një disiplinë e re e dekadës së fundit
- SNRAP 2015 – 2020 objektivi *2.3 Përdorimi sistematik i vlerësimit të hapësirave korruptive të legjislacionit (corruption proofing).*
- Përmendet më herët nga projekti PACA (2011) por për herë të parë nis të zbatohet në kuadër të projektit për "VLERËSIMIN E HAPËSIRAVE PËR KORRUPSION NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR" mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Hollandës, programi MATRA

PROJEKTI I IDRA SYNON:

- Përmirësimin e proçesit të hartimit të legjislacionit.
- Aftësimi i ekspertëve ligjorë në përdorimin e kësaj disipline.
- Të krijojë një formë presioni nga publiku meqënëse vlerësimi i akteve është në platformën online.
- I shërben Parlamentit si burim referimi gjatë diskutimit të projektligjeve

HAPAT E NDJEKUR :

- Hartimi dhe përditësimi i metodologjisë «Vlerësimi i Hapësirave për Korrupsion në Legjislacionin Shqiptar» .
- Përzgjedhja dhe trajnimi i një grupi ekspertësh ligjorë.
- IDRA dhe Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi më 15 prill 2016.
- Cdo akt ligjor → një raport vlerësimi.

METODOLOGJIA

- Eshtë hartuar mbi bazën e :

  - Manualit të Hartimit të Ligjeve, hartuar nga BE dhe KE, përditësuar nga EURALIUS

  - Metodologjinë mbi “Vlerësimin e hapësirave për korrupsion për aktet ligjore dhe draft aktet për ekspertët ligjorë”, hartuar nga Projekti PACA, 2011.

- U drejtohet personave që marrin pjesë në përgatitjen e vlerësimin e praktikave korruptive të projektligjeve dhe projektakteve të tjera.

QËLLIMI

- të udhëzojë zyrtarët shqiptarë gjatë procesit të hartimit, diskutimit dhe miratimit të legjislacionit nga këndvështrimi i minimizimit ose mënjanimit të hapësirave korruptive që mund të krijohen.

- shërbejë si udhëzues për përmirësimin dhe ruajtjen e cilësisë së lartë në ligj- bërje si dhe parandalimin e hapësirave korruptive të legjislacionit në Shqipëri

RAPORT -VLERËSIMI

Raport- vlerësimi përbëhet nga 4 (katër) seksione kryesore:

1. **Vlerësimi i Përgjithshëm** (institucioni propozues i projekt-aktit, kategoria dhe qëllimi i projekt-aktit)
2. **Justifikimi i Draftit** (relacioni shpjegues që shoqëron aktin, mjaftueshmëria e arsyetimit dhe justifikimi ekonomiko financiar)
3. **Vlerësimi i hapësirave për korrupsion** (promovimi i interesave/përfitimeve që bien ndesh me interesin publik, dëmet që i shkaktohen interesit publik nga zbatimi i ligjit, përputhshmëria e draftit me dispozitat e parashikuara nga legjislacioni kombëtar ekzistues, formulimi gjuhësor i draftit, rregullimi i aktivitetit të autoriteteve publike)
4. **Analiza e detajuar e hapësirave për korrupsion** në dispozitat ligjore të draftit.

PROBLEMATIKAT E VLERËSUARA

- Gjuha e përdorur.
- Koherenca e draftit dhe ndërveprimi i tij me legjislacionin ekzistues
- Mënyra e vendosjes dhe përkufizimit të detyrave të autoriteteve publike.
- Justifikimi, interesi publik dhe mënyra e ushtrimit të të drejtave dhe përmbushjes së detyrave.
- Transparenca dhe qasja në informacion.
- Llogaridhënia dhe Përgjegjësia.
- Mekanizmat e kontrollit.

- Janë vlerësuar në total nga ekspertët **62 akte ligjore**.
- 38 ligje/projektligje, 24 draft VKM ose VKM në fushat :

Shëndetësi(4 akte)

Arsim (2 akte)

Ekonomi (16 akte)

Shërbime Publike (12 akte)

Drejtësi (19 akte)

Mirëqënie Sociale (8 akte)

- Në secilin prej këtyre akteve është gjendur të paktën një nga problematikat e trajtuara në metodologjinë «Vlerësimi i Hapësirave për Korrupsion në Legjislacionin Shqiptar».

Problematikat	Akte të gjetura me probleme	%
1. Gjuha e përdorur	46 nga 62 akte	74 %
2. Koherenca e draftit dhe ndërveprimi i tij me legjislacionin ekzistues.	40 nga 62 akte	65 %
3. Mënyra e vendosjes dhe përkufizimit të detyrave të autoriteteve publike	35 nga 62 akte	56 %
4. Justifikimi, Interesi publik dhe mënyra e ushtrimit të të drejtave dhe përmbushjes së detyrave	27 nga 62 akte	44 %
5. Transparenca dhe qasja në informacion	26 nga 62 akte	42 %
6. Llogaridhënia dhe Përgjegjësia	28 nga 62 akte	45 %
7. Mekanizmat e Kontrollit	25 nga 62 akte	40 %

1. GJUHA E PËRDORUR

- Drafti i një akti ligjor përmban terma ose formulime të cilat janë të paqarta ose të dykuptimshme.

- Përdorimi jo i njëjtë i termave në tekstin e draftit, ku përdoren terma të ndryshme për të treguar të njëjtën dukuri ose të njëjtin term për t'ju referuar dukurive të ndryshme.

- Përdorimi i termave që nuk njihen në legjislacion, që nuk janë shpjeguar qartë në tekstin e draftit.

- ***Akti "Vendim Nr. xx / 2016 "Për disa shtesa në vendimin nr. 413, dt. 25.06.2016 të KM .***

Në **pikën II** të këtij akti parashikohet se: "*Drejtoria e drejtimit të pronës në Ministrinë e Financave,* ***mund*** *t'i kërkojë bashkisë përkatëse, nëse trualli i cili kërkohet të privatizohet përdoret për interes publik apo edhe është pronë e saj i transferuar në bazë të ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtëshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar…*"**.** Përdorimi i termit **mund** në këtë fjali, lë në diskrecionin e autoritetit kryerjen e veprimit dhe krijon paqartësi në lidhje me detyrimet e këtij autoriteti. Në të njëjtën pikë, fjalia e dytë *parashikohet se kjo drejtori "* ***do të*** *njoftojë Ministrinë e Punëve të Brendshme*...". Përdorimi i foljes në kohën e ardhme, sjell që ky parashikim të mos interpretohet si detyrim i autoritetit për të njoftuar Ministrinë, por sikur e lë njoftimin në diskrecionin e autoritetit publik.

- ***Ligj Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”.***

Në **nenin 7** parashikohet se: *“Një subjekt për të mbajtur statusin e ndërmarrjes sociale duhet të plotësojë një minimum kriteresh të natyrës ekonomike dhe sociale.”* Shprehja **"minimum kriteresh",** është e paqartë, pasi duhet të përcaktohet shprehimisht numri minimal i kritereve që duhet të plotësojë subjekti.

- ***Vendim "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.408, Datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", të ndryshuar***

Në **nenin 13 pika 4** «*Zyra përgjegjëse, pranë autoritetit kompetent, kryen verifikimet lidhur me transferimin e lejes dhe, në rast se nuk vëren parregullsi, kryen, pa vonesë, regjistrimin e të dhënave të titullarit të ri të lejes në regjistrat përkatës dhe njofton palët e interesuara, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve***.”**

Togfjalëshi "**pa vonesë**" nuk është i duhuri, afati nuk është specifikuar dhe specifikimi i tij lihet në diskrecion të institucionit apo personit përgjegjës për kryerjen e veprimit procedural administrativ duke rritur mundësitë e abuzimit në praktikë.

2. KOHERENCA E DRAFTIT DHE NDËRVEPRIMI I TIJ ME LEGJISLACIONIN EKZISTUES

- Sigurimi **i koherencës së tërësisë së ligjeve** duke eleminuar konfliktet mes dispozitave të ndryshme legjislative që mund të shfaqen gjatë procesit legjislativ.
- **Dispozitat e referencës** vlerësohen të gabuara kur është e vështirë të identifikohet baza ligjore ku referojnë ato apo kur nuk ka fare një bazë të tillë.
- **Dispozita deleguese të gabuara**, i japin një autoriteti tjetër një kompetencë të pajustifikuar për të vendosur në mënyrë të pavarur rregullore, ndalime dhe përjashtime të detyrueshme.
- **Dispozitat konkuruese**, krijojnë një konflikt midis tyre, të cilat mund të jenë brenda një drafti apo midis një drafti dhe një ligji ekzistues, një norme të brendshme apo ndërkombëtare. Konflikt i jashtëm mund të vijë midis akteve të të njëjtës fuqi ose midis akteve të fuqive të ndryshme.
- **Boshllëku legjislativ** janë rastet e mos rregullimit të plotë nga ana e legjislatorit të marrëdhënieve të ndryshme shoqërore.

- ***Ligji Nr.13/2016 "Për Mënyrën e ofrimit të Shërbimeve Publike në Sportel në Republikën e Shqipërisë".***

Në **Nenin 7, pika 4** thuhet**:** "*Refuzimi i dhënies së informacionit, sipas këtij neni, do të bëhet kryesisht, në përputhje me kufizimet e parashikuara nga legjislacioni për të drejtën e informimit ose edhe kufizime të tjera të parashikuara në ligje të veçanta*". Në këtë rast, neni nuk e përcakton në mënytë të detajuar, se cilit ligji do i referohemi në rast refuzimi të dhënies së informacionit.

Në **Nenin 8, pika 1 dhe 2** thuhet**:** "*Në çdo rast duhet të respektohen kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen nga diskriminimi*". Sipas këtij formulimi, nuk përcaktohet në mënyrë të detajuar ligji që i referohet kjo dispozite.

Në **Nenin 9, pika 2** thuhet: "*Procedura administrative e ofrimit të shërbimeve zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, në përputhje me afatet e përcaktuara në legjislacionin që rregullon shërbimin specifikisht*". Edhe në këtë rast nuk kemi një përcaktim të legjislacionit, gjë që krijon konfuzion në zbatimin e kësaj dispozite.

- **Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore"**

Është ndryshuar gjithsej **11 (njëmbëdhjetë) herë.** Ndryshimi i ligjit në mënyrë të vazhdueshme, rrit vështirësinë e të kuptuarit duke shkaktuar konfuzion dhe paqartësi Kjo ndosh edhe kur ndryshimet janë të qarta duke mos lënë vend për interpretime të ndryshme.

- **Ligj Nr. 146/2015 "Për Punëkërkuesit"**

Në nenin 4/3 «*Punëkërkuesi i regjistruar duhet të paraqitet çdo muaj në zyrën e punësimit, apo sa herë i kërkohet një gjë e tillë prej saj*» duhet përcaktuar se në çfarë mënyre do të behet kërkesa për paraqitje të punëkërkuesit në zyrën e punësimit dhe se si do të vërtetohet që ai ka marrë njoftim. Eshtë një përcaktim evaziv, në një farë mënyre i jep pushtet diskrecional punonjësit të zyrës së punës

3. MËNYRA E VENDOSJES DHE PËRKUFIZIMIT TË DETYRAVE TË AUTORITETEVE PUBLIKE

- **Kompetencat e gjera rregullatore**, si dispozita që pajisin një autoritet publik me të drejta të rregullimit ligjor në fusha që shkojnë përtej kompetencave të tyre.
- **Përgjegjësi tejet të gjera apo përgjegjësi** në kundërshtim me statusin e autoritetit publik.
- **Përgjegjësi të parashikuar** në një mënyrë që lejon interpretime të ndryshme dhe abuzive.
- **Detyra paralele**, në rregullime që parashikojnë detyra për një institucion të caktuar në draftin e ri ndërkohë që detyra identike ose të ngjashme janë parashikuar në të njëjtin draft ose në një akt tjetër për një organ tjetër.
- **Mungesë/paqartës**i e rregullave procedurale administrative.
- Kur **procedurat administrative** nuk janë vendosur ose përkufizuarnë mënyrë të qartë,
- **Afatet administrative** të cilat janë tepër të gjata ose tepër të shkurtra bëjnë të vështirë ushtrimin e të drejtave dhe interesave.

- ***Akti Vendim "Për disa shtesa në vendimin nr. 413, dt. 25.06.2016 të KM, " Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të shitjes së trojeve në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme dhe trojeve shtesë funksionale të ndërmarrjeve, shoqërive tregëtare, të objekteve shtetërore të vecanta, të privatizuara, të objekteve apo ndërtesave të shitura të ish kooperativave bujqësore, si dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit".***

Në **pikën I.3** të vendimit parashikohet afati **10 ditor** për ZVRPP, ndërkohë që vetë ligji nr.33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", parashikon afatin **15 ditor** për trajtimin e kërkesave. Pavarësisht qëllimit të këtij parashikimi, për të qënë koherent në parashikimin e afatit si në pikat e tjera të VKM nr.413 datë 25.06.2014, kjo dispozitë nuk mund të krijojë afate të reja detyruese, të cilat bien ndesh me parashikimet ligjore ekzistuese.

- ***Projektligj Nr.___ /2016 "Për Shërbimin e Provës".***

Në **nenin 19, pika 8** e këtij projekt ligji parshikohet: "*Punonjësi përgjegjës i Shërbimit të Provës vlerëson arsyet e dokumentuara që kanë penguar vendosjen e kontaktit për të dënuarin*»Për vlerësimin e arsyeve të dokumentuara punonjësi i Shërbimit të Provës, në rastet kur e vlerëson të nevojshme, ka të drejtën të kërkojë konfirmim zyrtar nga institucionet shtetërore". Në këtë akt termi "**<u>në rastet kur e vlerëson të nevojshme</u>",** është term që krijon kushte për liri vetëgjykimi.

- ***Vendim i KM "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.408, Datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar.***

Në **pikën 15 të këtij Vendimi** parashikohet që, "*Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, kur shikohet e nevojshme krijojnë funksione të reja, të cilat nuk janë përcaktuar në lidhjet që i bashkëlidhen këtij vendimi, bëjnë njehsimin e tyre, për efekt page, me klasifikimin e miratuar në lidhjet përkatëse të pagave*". Në këtë VKM nuk parashikohen as **kriteret** mbi bazën e të cilave do të bëhet llogaritja dhe as **rastet/situatat "e nevojshme**" kur mund të krijohen funksionet e reja. Kjo gjë lejon hapësira për abuzim si me fondet publike ashtu edhe me funksionet.

- ***Tek ligji Nr. 35/2016 "Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejta të Tjera të Lidhura me To".***

Neni 140 pika 3 thuhet se:" *Përdoruesi i paraqet AAK-së,(Agjensia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave) pa vonesë, informacion në lidhje me çdo ndryshim të rrethanave të përdorimit ose të përfundimit të tij, në mënyrë që të ndryshohen kushtet, në të cilat është dhënë autorizimi ose për ta tërhequr atë*", përdorimi i termit **pa vonesë** krijon konfuzion dhe lejon autoritetin publik që ta shfrytëzojë afatin kohor sipas interesave të tij.

Neni 145 pika 2 "*Kur e konsideron të nevojshme, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, KKDA-ja (Këshilli Kombëtar i të Drejtave të Autorit)mund të miratojë, gjatë procedurës dhe me propozimin e palës, një vendim për caktimin e tarifës për kohëzgjatjen e procedurës para KKDA-së. Vendimi lëshohet në bazë të informacionit ekzistues gjatë vendimmarrjes dhe do të jetë në fuqi derisa të jepet vendimi i përmendur në pikën 1, të këtij neni»*. Vendimi, sipas kësaj pike, nuk i nënshtrohet ankimit**."** Përdorimi i termit **kur e konsideron të nevojshme** , **duke marrë parasysh rethanat e rastit**, krijojnë kushte për liri vetëgjykimi nga autoriteti publik.

- **Ligj Nr. 47/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, të ndryshuar**

Lidhur me nenin 3 të ligjit, në pikën 1 parashikohet «*Krijimi i Bordit të Mbikëqyrjes Publike, me statusin e një autoriteti rregullator të pavarur*». Ndërkohë që anëtarët e Bordit emërohen nga ministri përgjegjës për financat. Për pasojë, është e paqartë përcaktimi që i jep ligji Bordit, si një "**autoritet rregullator i pavarur**". Pika 3 e nenit 5 të ligjit parashikon se «*Bordi, në ushtrimin e funksioneve të veta mbikqyrëse, të sigurimit të cilësisë dhe administrative, asistohet nga një strukturë mbështetëse e cila angazhohet në kontrollin e sigurimit të cilësisë*.»Eshtë e paqartë se çfarë nënkupton termi **angazhim** përsa kohë që kjo strukturë kontrollon cilësinë duke dubluar në këtë mënyrë kompetencat dhe detyrat e Bordit.

4. JUSTIFIKIMI, INTERESI PUBLIK DHE MËNYRA E USHTRIMIT TË TË DREJTAVE DHE PËRMBUSHJES SË DETYRAVE

- Hartuesi duhet të përcaktojë **çfarë duhet rregulluar me ligj**, **kujt i drejtohet ligj**i si dhe ku është **interesi publik** në hartimin e këtij ligji.
- Çdo draft duhet të jetë i shoqëruar nga **relacioni shpjegues**, i plotë dhe i detajuar.
- Qëllimi i çdo ligji është që t'iu sigurojë atyre të cilëve iu drejtohet **një rregullim sa më të saktë dhe të kuptueshëm të problemit që shqyrtohet**.
- **Kosto të ekzagjeruara për zbatimin dispozites në raport me përfitimin publik**, *janë rasti i shpenzimeve tejet të mëdha publike apo private në zbatimin e aktit që propozohet në raport me avantazhet që përfitohen*.
- **Kërkesat e tepruara për ushtrimin e të drejtave/ përmbushjen e detyrimeve**, këto rreziqe ndodhin në rastet kur dispozita vendos kërkesa të shumta ose tepër të ndërlikuara dhe të vështira për një detyrim që duhet të realizohet nga qytetari.
- **Dispozitat e pazbatueshme**, janë dispozita të cilat për shkak të rrethanave të vecanta të fushës së rregulluar, nuk mund të ekzekutohen sepse nuk përputhen me realitetin dhe marrëdheniet sociale.

- ***Tek Ligj Nr. 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë",***

Promovimi i interesave/përfitimeve të cilat bien ndesh me interesin publik nga përmbajtja e aktit konstatohen se realizohen në mënyrë indirekte, pasi psikologët që i nënshtrohen ligjit nr.40/2016 favorizohen krahasuar me profesionet e tjera të rregulluara nga ligji 10171/2009. Kjo për faktin se të ushtrosh veprimtarinë e psikologut sipas ligjit, mjafton vetëm të antarësohesh në Urdhrin e Psikologut, duke shmangur kriteret e tjera të parashikuara për profesionet e rregulluara si praktika profesionale apo provimi i shtetit (kritere të detyrueshme të përcaktuara nga ligji kuadër nr. 10171/2009). Ky favorizim bie ndesh me interesin publik dhe synimin që ka ligji nr.40/2016, ofrimi i një shërbim cilësor subjekteve të interesuara nga persona të kualifikuar dhe licencuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- **Ligj nr. 155/2015 "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë"**

Rregullore e Këshillit të Ministrave sipas neneve 14 dhe 20 përcakton se duhet të hartohet një raport vlerësues i të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, i vecantë nga relacioni i ligjit, bashkëlidhur me të, gjë që nuk është në rastin konkret. Përpos faktit që relacioni dhe ligji janë në të njëjtën linjë objektivash dhe parashtrimesh ligjore, evidentojmë se disa teknikalitete për zbatimin e tij kanë parashikime të ndryshme si psh. mosha e lojtarëve që lejohen të luajnë dhe punonjësve në lojërat e fatit ku në relacion është vendosur **mosha 18 vjec** ndërsa në ligj është **mosha 21 vjec** si moshë minimale. Gjithashtu evidentojmë se në relacion parashikohet të **ndalohen** lojërat online, ndërsa ligji i **lejon** dhe i rregullon sipas kushteve të shprehura në po këtë ligj, si dhe numri maksimal i NIPT sekondare të basteve sportive dhe distancës mes tyre, paraqet ndryshime mes relacionit dhe ligjit.

- ***Projektligji "Për ndihmën juridike",***

Në tërësinë e Projektligjit "Për ndihmën juridike", rezulton se objekt i tij është vetëm ndihma juridike në fushën civile dhe administrative, kurse **ndihma juridikë në fushën penale nuk parashikohet**.në kushtet kur :

- Ndihma juridike falas në fushën penale është një e drejtë që parashikohet nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.
- Mos parashikimi i kësaj të drejte në këtë projektligj sjell dëmtimin e një grupi të caktuar personash, të cilët e gëzojnë këtë të drejtë nga Kushtetuta e Republikë së Shqipërisë

5. TRANSPARENCA DHE QASJA NË INFORMACION

Mungesa e aksesit në informacion me interes publik Këto janë raste mungese apo pamjaftueshmërie rregullimi në lidhje me të drejtën për tu informuar mbi të dhënat, faktet, situatat që lidhen me subjektin apo interesin publik, mundësi që duhet të arrihet pa një përpjekje të vecantë. Përpjekja për mungesë transparence nxit dhe përpjekjet për të marrë informacion nëpërmjet influencave.

- ***Tek Ligj Nr. 40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë"***

Detyrat dhe kompetencat e Presidentit të Urdhrit nuk parashikohen në ligj sikundër ndodh me autoritetet e tjera të krijuara me këtë ligj.

- ***Tek ligji 27/ 2016 " Për menaxhimin e kimikateve"***

Neni 6 pika 3/dh parashikon *publikimin e listave SVHC dhe listës kandidate nga Zyra për Kimikatet,* por nuk është parashikuar mënyra e publikimit.

Neni 20 parashikon *ndalimin e përdorimit të substancave me rrezikshmëri shumë të lartë*, por në pikën 5 ku parashikohet " *Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC), kriteret për përfshirjen e substancave në listën SVHC dhe lëshimi i një autorizimi të kushtëzuar, me qëllim vazhdimin e përdorimit të SVHC-së miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit*." sipas këtij neni **parashikohet lëshimi i autorizimit të kushtëzuar për vazhdimin e përdorimit. Nuk ka asnjë parashikim në ligj për fillimin e përdorimit. Ky autorizim nuk regjistrohet në QKL, duke sjellë mungesë transparence**.

- ***Vendimi 825 dt. 07.10.2015 "Për përcaktimin e kritereve e të procedurave për dhënien e lejës për hapjen, mbylljen dhe funksionimin e institucioneve private të arsimit parauniversitar, në të cilat zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mesimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj"***

Në funksion të transparencës përmbajtja e aktit paraqitet problematike pasi konstatohet se:

1-Ka një **përcaktim jo të qartë të rregullave** të funksionimit të institucioneve që rregullon ky akt;

2-Mungon specifikimi i autoritetit inspektues dhe monitorues i këtyre institucioneve, si dhe parashikimi i procedurës së inspektimit, detyrimet dhe përgjegjësitë e këtij autoriteti.

3-Nuk ka asnjë parashikim lidhur me sigurimin e aksesit të informacionit për publikun apo palët e interesuara, psh parashikimi i një dispozite lidhur me mbajtjen dhe publikimin e një regjistri on-line në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku të përcaktohen institucionet të cilat kanë një licensë dhe ushtrojnë aktualisht një veprimtari të tillë, ato të cilave u është pezulluar apo u është hequr e drejta e ushtrimit të një veprimtarie të tillë si dhe çdo informacion tjetër lidhur me procedurën dhe kriteret për marrjen e licensës, pezullimin etj.

- ***Projektligji “ Për Avokaturën e Shtetit”***

Mungon një procedurë për kontraktimin e avokatëve ose zyrave të avokatisë vendase ose të huaja, në përfaqësim dhe mbrojtje të interesave të shtetit shqiptar.

6. LLOGARIDHËNIA DHE PËRGJEGJËSIA

- Mungesa e llogaridhënies nga ana e autoriteteve publike në rast shkeljeje të dispozitave ligjore
- Mungesa e dënimeve të qarta për shkeljen e dispozitave të draftit.
- Vendosja e dënimeve të pasakta për shkeljen e dispozitave të draftit
- Paqartësia e përgjegjësive ligjore për të njëjtën shkelje.
- Shkaqet joshteruese për ngarkimin me përgjegjësi ligjore.

- ***Vendim Nr. 124, Datë 5.3.2014 "Për Miratimin e Statutit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"***

VKM nuk parashikon asnjë dispozitë lidhur me llogaridhënien e veprimtarisë së Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë

- ***Vendim Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.408, Datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", të ndryshuar***

Në asnjë prej dispozitave të rregullores (përfshirë edhe dispozitat që mbeten të pandryshuara ashtu siç janë në rregulloren e miratuar me vendimin nr.408 datë 13.5.2015) **nuk sanksionohet garantimi i të drejtës së ankimimit të subjektit të interesuar, kundër refuzimit të vendimit, të autoritetit përgjegjës, për shqyrtimin e kërkesave për leje**. Nëse qëllimi, i hartuesve të rregullores, është të aplikojnë rregullat e përgjithshme të ankimit administrativ ndaj aktit administrativ, të sanksionuara nga Kreu II i Kodit të Procedurave Administrative, atëherë një referim i tillë duhej të ishte bërë në dispozitat e rregullores sepse heshtja rreth kësaj çështjeje, **shkel të drejtat e garantuara me Kushtetutë të subjekteve dhe është në kundërshtim me interesin publik.**

- ***Ligj Nr. 147/ 2014 " Për Shërbimin e Urgjences Mjekesore".***

Mekanizmat e kontrollit ushtrohen nga organet më të larta hierarkike në ligj ka një mungesë e ndjeshme të parashikimeve mbi mekanizmat mbikqyrës. Mungojnë procedura të qarta të kontrollit mbi zbatimin e parashikimeve të draftit. Në ligj përmendet vetëm Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore si institucioni i vetëm përgjegjës, por nuk permendet asnjë institucion tjetër për të siguruar mekanizmat e kontrollit, kjo përbën një boshllëk të madh që sjell pasoja korruptive.

7.MEKANIZMAT E KONTROLLIT

- **Mungesë/pamjaftueshmëri e mekanizmave mbikqyrës (hierarkike, të brendshme dhe publike)**

Këto janë situata ku ka një mungesë e ndjeshme të parashikimeve mbi mekanizmat mbikqyrës. Evidentohen kur mungojnë parashikimet për kufizimet për përfshirjen e nënpunësve publikë në marrëdhënie pasurore; mungojnë parashikimet për mundësinë për kontroll parlamentar, gjyqësor apo administrativ, si dhe për kontroll publik, nëpërmjet kërkesave, informacioneve që mund të merren nga shoqëria civile etj.

- **Mungesë/pamjaftueshmëri e mekanizmave për tu ankuar kundër vendimeve dhe veprimeve të autoriteteve publike**

Rreziku qëndron në krijimin e një pushteti të pasfidueshëm diskrecional pa mundësi kontrolli. Identifikohet edhe nëpërmjet analizës së normave konkurruese, boshllëqeve legislative, mungesës së parashikimeve mbi procedurat administrative, etj.

- ***Tek akti Projektligj nr. xx Dt. xx "Për Zhvillimin e Mjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë dhe Sigurimin e të Drëjtës së Kalimit"***

- Nuk parashikohen mekanizma kontrolli ndaj Auoriteteve Përgjegjëse sikurse, ky projektligj ngarkon me detyra një sërë institucionesh.
- Mungon përcaktimi i përbërjes dhe përzgjedhjes së komisionit ad hoc që shqyrton ankimimet ndaj vendimmarrjes së komisionit disiplinor. Për më tepër krijon konfuzion se kush është organi që shqyrton ankimin, pasi pika 2 e nenit 21 parashikon së Këshilli Kombëtar e merr në shqyrtim vetë ose ngre një komision ad hoc dhe jep vendimin për ankesën e paraqitur.

- ***Ligj Nr. 65/2016 "Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë",***

- Ka mungesë parashikimesh mbi mekanizmat mbikëqyrës duke referuar në terma të pergjithshëm inspektoriate apo organe inspektuese.
- Mungojnë procedurat e qarta të kontrollit mbi zbatimin e parashikimeve të ligjit, por referohet në ligjin për inspektimin.
- Mungojnë mekanizmat për tu ankuar si ndaj refuzimit ashtu dhe ndaj humbjes së statusit të ndërmarrjes sociale.

PORTALI INTEGRITETIT LEGJISLATIV

Vizitoni faqen www.integrity.idra.al

- Është dizenjuar, një databazë elektronike me qëllim pasqyrimin e raporteve për ruajtjen e informacionit dhe ndjekjen hap pas hapi të proçesit të vlerësimit të hapësirave për korrupsion.

- Një sistem vlerësimi i "rrezikut për korrupsion" aplikohet për secilin nga raportet, dhe portali rendit aktet ligjore në varësi të këtij indikatori, në mënyrë që fushat më në rrezik të monitorohen. Portali, mes të tjerave, synon të shërbejë gjithashtu për të informuar dhe edukuar publikun mbi këto çështje.

- Nëpërmjet kësaj databaze synohet bërja transparente e vlerësimit për publikun si dhe monitorimi nëse rekomandimet e bëra janë marrë në konsideratë ose jo.

Portali Integritetit Ligjor

Kreu | Rreth Projektit | Njoftime | Aktet Ligjore | Kontakt

Vlerësimi i Hapësirave për Korrupsion në Legjislacionin Shqiptar

Kërko Akt Ligjor

Projekti për "Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion në Legjislacionin Shqiptar" synon të ndërtojë një sistem për një vlerësim profesional të hapësirave për korrupsion të legjislacionit në Shqipëri.

Juristë nga fusha të ndryshme do të shqyrtojnë projekt-akte specifike të injicuara nga ministritë e linjës apo autoritete te tjera sipas përcaktimeve të bëra nga të legjislacioni në fuqi. Për shqyrtimin e këtyre projektakteve dhe hartimin e raportit vlerësues, ekspertët do të bazohen në metodologjinë mbi "Vlerësimin e Hapësirave për Korrupsion në Legjislacion Shqiptar".

Aktet Ligjore të Vlerësuara

Gjurmimi i Akteve Ligjore

Aktet Ligjore më problematike

Rreth Nesh

Njoftimet e Fundit

Adresa

Faleminderit për vëmendjen !

☺ ☺ ☺ ☺ ☺

Pyetje ???

© Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi